

” NDIKIMI I MIKORIZËS NË ZHVILLIMIN E BORONICËS NË FUSHË DHE VAZO TE KULTIVARËT DUKE DHE DRAPER ”

ABSTRAKTI

Boronica është një kulturë pemëtare me vlera të larta ushqyese dhe tregtare. Rritja e rendimenti dhe cilësisë së frutave është një interes i veçantë. Kjo mund të arrihet vetëm me përmes zbatimit të teknologjive dhe teknikave të reja të prodhimit. Marrë parasysh faktin mbi përhapjen e kulturës së boronicës që po ndodhë kohëve të fundit në vendin tone si dhe në vendet tjera ka ngjallur shumë pyetje rreth formës me të përshtatshme të kultivimit si dhe trajtimet që duhet bërë që të kemi një rendiment sa më të lartë për njësi të sipërfaqes. Në rastin tonë janë hulumtuar dy kultivarë të boronicës (Duke dhe Draper), dy mënyra të kultivimit (fushë dhe vazo) dhe tri tretmanët me mikorizë (tri tretmanë: Myco Apply, Nutria Bio + Trichowel dhe pa trajtim). Për secilin kultivarë për hulumtim janë marrë nga 9 bimë të vendosura në tri përsëritje. Në studim janë përfsh hulumtimi i parametrave biologjik, morfologjik, pomologjik, prodhues dhe biokimik. Nga rezultatet e fituara është konstatuar se janë shfaqur ndryshime të konsiderueshme në mes të varianteve të testuar. Në rastin konkret kultivari më prodhues ka dalë Draper, forma e kultivimit në vazo më e suksesshme dhe përdorimi i mikorizës ka dhënë një ndryshim të madh si në rendiment ashtu edhe në cilësi të frutave.

Fjalët kyçe: Boronica, kultivarët, mikoriza, vendi i kultivimit

Mentor:

Prof. Ass. Dr. Vahid Avdiu

Kandidati:

Bsc. Drilon Blakaj